

JETA ME KUR'AN

SISTEMI MORAL / ETIK NE ISLAM - 04



Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha

PERMBAJTJA



ETHICS

1

VAZHDIM...ETIKA SOCIALE- NDALESAT DETALISHT

2

ETIKA SOCIALE - TE LEJUARAT DETALISHT

3


...DISA EDUKATA TE PERGJITHSHME ...ETIKA E DHENJES

4

HYRJA ME LEJE, MOS NGRITJA E ZERIT, DALJA ME LEJE

5

ETIKA SHETERORE...DO TE TRANSFEROHET NE SISTEMIN POLITIK



SA PER RIKUJTIM..

SISTEMET KUR'ANORE
te Sheriatit Islam per te
MIREN E NJERZISE



5- SISTEMI EKONOMIK



4- SISTEMI SOCIAL

6- SISTEMI POLITIK



3- SISTEMI FAMILJAR

7-SISTEMI I VAKUFEVE



2- SISTEMI MORAL /
ETIK





1- SISTEMI I BESIMIT



- **PER NJE REVOLUCION TE HESHTUR MORAL / ETIK**
- **REVOLUCION QE BURON NGA BRENDIA E ZEMRES SE MUSLIMANIT TE SINQERTE..**
- **QE REFLEKTOHET POZITIVISHT NE SJELLJET E TIJA ME TE TJERET..**

ETIKA INDIVIDUALE

1



ETIKA SOCIALE


2

ETIKA SOCIALE

NDALESAT

URDHERESAT

***LIGJE EDUKATIVE
TE PERGJITHSHME***



PJESA E PARE:

**KODI ETIK SOCIAL
NE DETAJE...**

1-NDALESAT ✓



ETIKA SOCIALE -NDALESAT

1

*.. Kush e mbytë një besimtarë me qëllim, dënimi itij është Xhehnemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. All-llahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe ika përgaditur dënim të madh.
(El Nisa:93)*

Vjedhësit dhe vjedhëses këputjuani duart e tyre, për ndëshkim të asaj që kanë punuar – dënim nga ana e Perëndisë; se, Perëndia, është i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm.(El Maideh:38)

VRASJA

VJEDHJA

MASHTRIMI

Mjer për ata që kur masin – mungojnë, Të cilët kur blejnë e marrin masën e plotë prej tjerëve, Por kur u masin të tjerëve me litër e kandar ua mungojnë.(El Mutaffifijne:1-3)

O besimtarë! Është porosi për ju ndëshkimi për vrasje: I liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën; e atij që ia falë fafisi i të vrrarit, duhet të sillet njerëzishëm (me mirësi për dëmshpërblim) dhe le të zbatohet dëmshpërblimi me të mirë. Kjo (falje) është një lehtësi dhe mëshirë nga ana e Zotit. E kushdo që pas kësaj (faljes), e kapërcen kufirin, për atë ka dënim të rreptë. O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri tjetrit).(El Bekare:178-179)

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

2

O besimtarë, frikësohuni All-llahut dhe,
nëse jeni besimtarë, hiqni dorë nga ajo çka
mbetet prej kamatës.
(El Bekare:278)

KAMATA

**MANIPULIMI/
POSEDIM I
PALIGJSHEM**

As njerëzve mos ua cenoni të
drejtat e tyre dhe mos bëni krime e
shkatërrime në tokë,...
(Eshuara'e:183)

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

3

*Kurse ata, të cilët, i ofendojnë besimtarët dhe besimtare për diçka që nuk e meritojnë, ngarkohen vetëm me shpifje dhe mëkate haptazi.
(El Ahzab:58)*

**NGRENJA/KEQPERDORIMI
I MALLIT TE JETIMIT**

*Bonjakëve (jetimëve) jepini kur të rriten pasurinë e tyre, dhe mos e ndërroni të pastërtin (mallin tuaj që e keni halall) me të ndytin (me haramin) edhe mos ehani pasurinë e tyre (të përzier) me asurinë tuaj, pse ky është mëkat i madh.
(En Nisa:2)*

**ETIKA
SOCIALE
-NDALESA
T**

**FYERJA/OFENDIMI I
DIKUJT PA ARSYE**

TRADHTIA

O besimtarë!, mos tradhtoni All-llahun dhe Profetin dhe me vetëdije të veni në dyshim besueshmërinë ndërmjet veti,(El Enfal:27)

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

4

E për sa u përket atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre u japë shpërblim të plotë. All-llahu nuk i do të padrejtët.)Al Imran:57)

E cilido ë bën padrejtësi prej jush, Ne i japim atij të përjetojë një dënim të madh.(El Furkan:19)

Ndihmone njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos ndihmoni në mëkat dhe armiqësi! Dhe frikësohuni All-llahut, sepse All-llahu është ndëshkimfortë.. (El Maide:2)

ZULLUMI/PADREJTESIA

PERKRAHJA E TRADHTAREVE

BASHKEPUNIM NE VEPRA TE KEQIJA

MOS-MBAJTJA E FJALES/THYERJA E PREMTIMIT

Ne të zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur'anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes nerzëve me atë që të mësoi All-llahu. Mos u ngatërro për tradhtarët (mos udil në ndihmë).. (En Nisa:105)

Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj All-llahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se All-llahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, All-llahu e di se çka punoni.,(En-nahl:93)

MBROJTJA E MEKATAREVE/KRIMINELEVE..VAZHDIM I AJETEVE PARAPRAKE

- *Dhe mos i mbroj ata që e tradhëtojnë vetveten (me mëkate)! Se, Perëndia, nuk i don tradhëtarët – mëkatarët. Ata fshihen (duke u turpëruar) nga njerëzit, e nuk fshihen nga Perëndia. E, Ai është me ta, (i di dhe i sheh) kur natën flasin gjëra me të cilat (Ai) nuk është i kënaqur...(En Nisa:107-108)*

KORRUPCIONI ME GJYQTARE/DHENIA E RYSHFETIT

- *Dhe mos e hani pasurinë e njëri- tjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me te (me ryshfet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini (se pa të drejtë po e hani atë).. (El Bekare:188)*

DESHMIA E RREJSHME

- *...pra largohuni nga ndyesitë e idhujve dhe largohuni fjalës shpifëse”.. .(El Haxh:30)*
- *(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet... (El Furkan:72)*

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

6

*Mos e fshehni dëshminë,
sepse ai që e fsheh atë është
mëkatar me zemrën e vet,
All-llahu di atë që veproni.(
El bekare:283)*

**MSHEFJA E SE
VERTETES**

**FJALA E
KEQE/ofenduese**

*Perëndia nuk don që të
flitet sheshazi e keqja (nga
askush), përveç nga të
dëmtuarit. Se Perëndia çdo
gjë dëgjon dhe çdo gjë
dinë. (En Nisa:148)*

**Pra, mos e përul jetimin! As
lypësin mos e përzë!(Ed
-Duha:9-10)**

**SJELLJA E
VRAZHDET ME
JETIMIN DHE TE
VARFERIN**

**TALLJA DHE
NENQMIMI I TE
TJEREVE**

*O ju që besuat, nuk bën të tallet një
popull me një popull tjetër, meqë të
përqeshurit mund të jenë më të
mirë nga ata të cilët përqeshin dikë
tjetër, e as gratë me gratë e tjera,
sepse mund të ndodhë që gratë e
tjera të jenë më të mira se ato që
përqeshin (duke nënçmuar
njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni
njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit
është keq të përhapet llagapi i keq.
E ata që nuk pendohen, janë
mizorë.(El Huxhurat:11)*

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. (Lukman:18)

BESIMI NE DEZINFORMATA

O besimtarë, nëse ndonjë njeri i pandershëm u sjell ndonjë lajm, sqarone mirë, që të mos e goditni (dikë) nga padijenja e pastaj të pendoheni për shkak të asaj që keni bërë. (El Huxhurat:6)

MENDJE MADHESIA NDAJ TE TJEREVE

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

SHPIFJA DHE PERGOJIMI

...e as mos përgojoni njëri-tjetrin.. (El Huxhurat:12)

..dhe mos spiunoni njëri-tjetrin .. (El Huxhurat:12)

SPIUNAZHA

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënimshumë i madh.(En Nur:23)

SHPIFJE NDAJ FEMRAVE MUSLIMANE/ te ndershme

Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk e dini..(En Nur:20)

ETIKA SOCIALE -NDALESAT

..ata ishin që nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënin ishte e shëmtuar.. (El Maideh:79)

PAJTIMI I PERHAPJES SE KEQES

INTERVENIM I KEQ/PER QELLIME TE KEQIJA

Ai që përpiqet për të mirë – edhe ai do të ketë pjesë në shpërblim, e ai që angazhohet për të keqe – edhe ai do të ketë pjesë në ndëshkim. – Se Perëndia është i Gjithëpushtetshëm . (En Nisa:86)

PJESA E DYTE:

**KODI ETIK SOCIAL
NE DETAJE...**

2-URDHERESAT ✓



ETIKA SOCIALE

1



ETIKA SOCIALE

~~**NDALLESAT**~~



URDHERESAT



**LIGJE
EDUKATIVE TE
PERGJITHSHME**

ETIKA SOCIALE -URDHERESAT

2

All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni. (EN nisa:58)

REALIZIMI I
EMANETEVE

O besimtarë! – (shënoni çfarëdo) borxhin kur ia jepni njëri-tjetrit në afatin e caktuar. Le të shënojë drejtë (atë që jepni e merrni) një shkruar në mes jush..El Bekare:282)

DESHMIA E
DREJTE

E, kur flisni, bëhuni të drejtë, qoftë edhe (kundër) të afërmit tuaj. Plotësoni obligimet e Perëndisë. Këto janë porositë e Tij, për t'ju këshilluar (El En'am:152)

O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmuar të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnyak,(En Nisa:135)

ETIKA SOCIALE
-URDHERESAT

TE VEPRUARIT ME
SHKRESA/KONTRATA
PER TA EVITUAR
DYSHIMIN

O besimtarë, zbatoni marrëveshjet! (El Maideh:1)

ZBATIMI I
MARVESHJEVE/
KONTRATAVE

Dhe kryeni obligimet. Me të vërtetë, për obligime jeni përgjegjës.(El Isra:34)

ETIKA SOCIALE -URDHERESAT

3

S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kinie frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (na Zoti). (El Huxhurat:10)

E ai nuk u hodh në përpjetëzen (rrugë e vështirë - qafëmalit). E ç'gjë të mësoi ty se ç'është Akabe (rruga e vështirë)? Është lirimi i një skllavi, (El Beled:11-13)

Dhe të pyesin ty për bonjakët, thuaju: "T'i bëni mirë atyre është vepër e bukur, e nëse jetoni bashkë me ta, ata janë vëllezërit tuaj, se Perëndia di të dallojë keqbërësin prej mirëbërësit.(El Bekare:220)

INICIATIVA PER PAJTIM DHE PAQE

Pranaj, druajuni Perëndisë dhe rregulloni mërrëdhëniet në mes jush dhe bëhuni të dëgjueshëm ndaj Perëndisë dhe Pejgamberit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë (El Enfal:1)

NDIHMJA PER LIRIMIN E SKLLEVERVE/apo te burgosurve te pafajshem ne kete kohe

MESHIRA DHE BUTESIA me tjetrin

Muhammedi është profet i All-llahut, kurse ata që janë me të janë të ashpër ndaj mosbesimtarëve, por të mëshirshëm ndërmjet veti (El fet'h: 29)

MIRIMBAJTJE E PASURISE SE JETIMIT/INVESTIM NE FAVOR TE JETIMIT

BAMIRESIA NDAJ TE TJEREVE(TE VARFERVE)

Adhurone All-llahun dhe asnjë send mos e trajtoni të barabartë me Të! Jini të mirë me prindërit dhe të afërmit, edhe bonjakët, edhe të varfërit e mjerë, edhe me fqinjët e afërm, edhe me fqinjët e largët, edhe me shokët për rreth, edhe udhëtarët, edhe ata që janë nën kujdesin tuaj. All-llahu, pa dyshim, nuk i don ata që janë mendjemëdhenj dhe arrogantë (En Nisa:37).

ETIKA SOCIALE -URDHERESAT

3

Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. (El Hashr:9)

Dhe ata që u shmangën mëkateve të mëdha e të shëmtuara, dhe kur hidhërohen, ata falin,(Esh-shura:37)

Edhe ata që kur i godit e padrejta, i kundërvihen. (Esh-shura:39)

dhe me të mirë e largojnë të keqen. Të tillët kanë përfundim më të mire (Er-ra'd:22)

Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shptuarit. (Ali Imran:104)

FALJA PER GABIME

VELLAZERIA & BUJARIA

DURIMI ME KUFU,

ETIKA SOCIALE

PREDIKIMI I DITURISE

SJELLJA E MIRE ME ATE QE SILLET KEQ

THIRJA NE TE MIRE DHE NDALJA PREJ KEQES

O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën-risalen).El maudeh:64)

ETIKA SOCIALE -URDHERESAT

4

**DASHURIA /RESPEKTI I
PERGJITHSHEM NDAJ
NJERI TJETRIT**

Ju jeni asi njerëzish që i doni ata, por ata nuk ju duan juve! Dhe ju u besoni të gjitha libravet. Kur ata ju takojnë juve, thonë: “Na besojmë”, e kur të mbeten vetëm, nga pezmatimi ndaj jush, ata i kafshojnë majet e gishtave me dhëmbë. Thuaju: “Vdisni me pezmatimin tuaj..(Ali Imran: 119)

DREJTESIA

Perëndia, me të vërtetë, urdhëron që të veprohet me drejtësi..(En Nahl:90)

MESHIRA

Perëndia, me të vërtetë, urdhëron që të veprohet me drejtësi, mirësi dhe t’u ndihmohet të afërmeve, e ndalon imoralitetin, (An Nahl:90)

**MIRESIA NDAJ
SKAMNOREVE..PER HIR
TE ALLAHUT**

All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zeqati etj.) t’ju takojnë vetëm: të varfëre (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare (, punonjësve që e tubojnë), atyre që duhet përfutur zemrat (të dobëtve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borgje, (luftëtarëve) në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.(Et Teubeh:60)

**DHENJA E
PERGJITHSHME**

Le të shpenzojë pasaniku sipas pasurisë që ka, por ai që ekonomikisht ka mungesa, le të shpenzojë nga e dhëna e Perëndisë; Perëndia nuk e ngarkon askë (më tepër) se sa i ka dhënë. Perëndia, me siguri, pas vështirësisë – sjell lehtësi.) Et Talak:7)

ETIKA SOCIALE

1



ETIKA SOCIALE

~~NDALESAT~~



~~URDHERESAT~~




LIGJE
EDUKATIVE TE
PERGJITHSHME



PJESA E TRETE:

1- ETIKA E DHENJES
2-DISA ETIKA TE
PERGJITHSHME PER
POPULLIN





ETIKA E DHENJES

1

MOS I HARRO KETO KESHILLA !!

O besimtarë! Mos e shëmtoni të mirën e lëmoshës suaj me reklamacion dhe fyerje, siç vepron ai që shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës, e nuk beson në Perëndinë dhe Ditën e Kijametit, (El Bekare:264)

ME E DHENE ATE ME TE MIREN

O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete pos symbyllas. Dhe dini se All-llahu nuk ka nevojë për ju, ngase është i Madhëruar. (El Bekare;267)

TE JETE FSHEHURAZI/JO PUBLIKE

Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, por nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju dhe Ai ua largon të këqiat. All-llahu është i njohur hollësisht për veprat e juaja. (El Bekare;271)

MOS TE OFENDOHE T I VARFERI PASTAJ ME FJALE

Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Perëndisë, e që nuk e përcjellin me reklamacion as fyerje, për ata ka shpërblym te Zoti i tyre, për ta nuk ka frikë as pikëllim. ..(El bekare:262)



O besimtarë! Le të kërkojnë leje ata që janë nën pushtetin tuaj (në familje) dhe ata nga ju, të cilët nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë në tri raste: **para namazit të sabahit dhe kur i zhveshni rrobat tuaja në mesditë dhe pas namazit të jacisë. Këto janë tri kohë kontestuese (jo të përshtatshme (En Nur:58)**

HYRJA ME LEJE NE VENDE TE CAKTUARA



O ju që keni besuar! Mos ngritni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos bisedoni me të me zë të lartë, ashtu si flitni zëshëm njëri me tjetrin, në mënyrë që mos t’u humbin veprat tuaja – e që ju të mos i hetoni.(El Huxhurat:2)

MOS NGRITJA E ZERIT



O besimtarë! Kur ju thuhet: “Bëni vend të tjerëve në ndejat tuaja!” – ju bëni vend, e madje Perëndia ju zgjeron juve. E kur ju thuhet: “Ngrituni ju”, - ju ngrituni..(El Muxhadele:11)

O besimtarë! Kur bisedoni mes jush, mos bisedoni për mëkate, armiqësi dhe padëgjueshmëri ndaj Profetit; por bisedoni për mirësi dhe ndershmëri. (El Muxhadele:9)

NDEJA E MIRE NE MEXHLIS DHE TEMAT E MIRA PER BISEDE

ETIKA TE PERGJITHSHME PER POPULLIN

3



Thuaju robërve të Mi, le të flasin atë që është më e bukur. Me të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa në mes tyre. Me të vërtetë, djalli është armik i hapët i njeriut. (El Isra:53)

FJALE TE EMBELA/TE MIRA

Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Perëndinë dhe Pejgamberin e Tij. E, kur të gjenden me te (Pejgamberin) në një punë të përbashkët, nuk largohen para se të kërkojnë leje prej tij. Me të vërtetë, ata që kërkojnë leje prej teje, padyshim, besojnë në Perëndinë dhe Pejgamberin e Tij. E, kur të kërkojnë ata leje prej teje, për ndonjë punë të tyre, jepju leje kujt ë duash prej tyre dhe kërko për ta falje nga Perëndia. Me të vërtetë, Perëndia është falës dhe mëshirues. (En Nur:62)

DALJA ME LEJE NGA MEXHLISI/MBLEDHJA

ETIKA SOCIALE

2



ETIKA SOCIALE

~~NDALLESAT~~



~~URDHERESAT~~



~~LIGJE
EDUKATIVE TE
PERGJITHSHME~~




**ETIKA E
SHTETIT/QEVERISE**



**KETE ETIKE DO TA BASHKANGJISIM NE
EMISIONIN TONE TE ARDHSHEM: SISTEMI
POLITIK..IN SHA ALLAH**

**MARDHENIJET(OBLIGIMET
DHE TE DREJTAT)
RECIPROKE-KRYETAR
-POPULL**



MARDHENIET E JASHTME



JU FALEMINDERIT

PER VEMENDJEN DHE KOHEN TUAJ



Email : drhafezi68@gmail.com



www.drhafezi.net